

PERLESHORJA E SHEN JOANIT PAGEZORIT T, IV, TAKHI PROKATALLAVE

Si nje thesár mistík, qe ishte fshehur ne dhé, ta gjeti Zoti Jesú, koken e shenjte pa çmim, Profét Pagezór Joán; mblídhuni pra te gjithë, ta kremtojme me bese, eni ta lavderojme, Zotin le ta hymnojme, i cili na shpctón prej prishjes me nermjetimin tent.

26. *Karpi, Apostull i Shenjte, nje prej te Shtatedhjetë Apostujve.*

27. *Helladi, Hierodeshmori i Shenjte.*

28. *Eftiku, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Melitines.*

29. *Theodosia, Deshmorja e Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN THEODOSISE, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmorja jote o Zot, me vojtje lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; ajó per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

30. *Isaaqi, Ati yne Oshenár, abati i Manastirit te Dalmáteve.*

31. *Hermeu, Deshmori i Shenjte.*

TE KREMTET E QERSHORIT

1. *Justini Fillosofi, Deshmori i Shenjte.*

2. *Nikifori, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopjes.*

3. *Lukiliani, Deshmori i Shenjte.*
4. *Mitrofani, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopojes.*
5. *Dorotheu, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Tyres.*
6. *Illarioni i Ri, Ati yne Oshenár.*
7. *Theodoti, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Ankires.*
8. *Trasferimi i lipsanit te Shen Theodorit Strate-llatit, Deshmorit te Math.*

PERLGSHORJA E THEODORIT STRATE-LLATIT, T. IV, O IPSOTHIS

O Athlofór i ushterise vertete, o gjencrál i Kryezotit te qellit, u-lavderove o Shen Theodór Strate-llát, se me arme dhe me ment, dhe me besë lef-tove, tufat e demóneve, i dermove me force, dhe u-tregove mundes me lavdí; te lumerojme, me besë pra gjithenjë.

9. *Kirili, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Aleksandrise.*

PERLGSHORJA E SHEN KIRILIT, T. T. IV. ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udheheqes Orthodóks, dhe mesonjes i beses dhe i perkores je, se na ke ndritur si nje yll, dhe u-tregove si shembell e Kryeprifterve, i urte Shen Kiríl, te gjithe i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, te shpe-tohen shpirtet tona.

10. *Aleksandri dhe Antonina, Deshmoret e Shenjte.*

PERLGSHORJA E SHEN ALEKSANDRIT,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtte lot e mundím, kurorc te ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuxímt' e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpethoven shpirtet tona.

11. *Barthollomeu dhe Barnaba, Apostujte e Shenjte.*

PERLGSHORJA E APOSTUJVE, T. III.

O Apostúj te Shenjte, lútjuni Zotit tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

12. *Onufri dhe Pjetri i Athonit, Aterit tane Oshenare.*

PERLGSHORJA E OSHENAREVE, T. II.

O Perendí i Aterve, qe na sillesh gjithenjë, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent per né; me lutjet e Aterve tane, qeveris-e jeten tone me paqe.

13. *Akilina, Deshmorja e Shenjte.*

14. *Elisheu, Profeti i Shenjte; Methodi, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Kostandinopojes.*

PERLGSHORJA E ELISHEUT, T. IV.

O Engjell o Shent Ellí, i lavderuar Profét, ti je Pareréndesi, per ardhjen e Zotit Krisht; u-çfaqe me trup mi né, dhe prej qellit i dergove, Elisheut dhuraten, dhe largove semundjet, dhe spastrove

leprozeti, dhe na dhurón sherime, edhe ndjesen e mekátave.

15. *Amosi, Profeti i Shenjte.*
16. *Tikoni, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Amathuntes se Kipros.*
17. *Isavri, Manuei, Sabeli dhe Ismaili, Deshmoret e Shenjte.*
18. *Leonti, Deshmori i Shenjte.*
19. *Juda, Apostulli i Shenjte.*
20. *Methodi, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Patárave.*
21. *Juliani i Tarses, Deshmori i Shenjte.*
22. *Eusebi, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Samosátave.*
23. *Agripina, Deshmorja e Shenjte.*
24. *Lindja e Shen Joanit, Profetit, Parerëndesit dhe Pagezorit te lavderuar.*

PËRLESHORJA E JOANIT PAGEZORIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Profét edhe Pagezór, i Zotit tone Jesús, sikunder te meritón, s' te lavderojme dot né, qe po te kremtojme sot; linde prej nje beronje, dhe nje áti te pagoje; qe te dy i gezove, i shpetove prej zise, dhe çpalle ardhjen e Zotit Krisht, ti Parerëndesi.

25. *Febronia, Deshmorja e Shenjte dhe Oshenare.*
26. *Davidi i Thesallonikes, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E DAVIDIT TË THESALLO-
NIKS, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mësim, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Engjëjtc, o Shen David i lumur lavdi me ty.

27. *Samsoni Gostellari, Ati ynë Oshenár.*

28. *Trasferimi i lipsánave të Kirit edhe Joanit, Anargjendeve të Shenjte.*

PERLESHORJA E ANARGJENDEVE, T. T. IV.

Shen Anargjende çudiberës, o Kir edhe Joán, vizitónani dhe shcrónani; darovisht e múarte, darovisht pra épnajeni.

29. *Shen Pjetri dhe Shen Pali.*

PERLESHORJA E APOSTUJVE, T. II.

O Parëfrónsit e Apostujve, dhe Mësónjesit e tere botes, nermjetoni pranë Zotit të gjithesisë, t' i dhuronjë paqen botes, dhe shpírteve tona përdellimin e math.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Si ta levdojmë sot, Shen Pjetrin Kryetarin? Aý e njohu Krishtin, aý i zuri kembën, dhe kyçet e Parajsës mban.

Si ta levdojmë sot, Shen Palin punëtorin? Mé

teper u-mundua, Ungjillin e perhapi, dhe Kishe themelój kudó.

Si t' i levdojme sot, Shen Pjetrin dhe Shen Palin? Se njéri ish i pari, dhe tjatri ish i zoti, pra tok i lusim qe te dy.

LAVDI. Tri here "A me do?" pyeti Pjetrin Krishti, dhe si u-shigurua, Barí mi dhent' e beri, per né pra lutet gjithenjé.

TANI. Drite prej qellit pé, kur shkonje ne Damaskë, dhe Krishtin e besove, Ungjillin e leçite, ne boten e pagáneve.

PASVARGJET, T. I, TON URANION

Si t' i tregojme mundimet dhe helmet pa pushím, qe vojte per Ungjillin, o Shen Pal i degjuar. Shetite themelove Kishe kudó, per ndriçím te pagáneve, edhe deshmove dhe vdiqe per Zotin Krisht, o Mesonjes i kómbeve.

Si t' i tregojme mundimet qe vojte o Shen Pal, pa buke dhe pa uje, ne debór' e ne vape, ne shpell' e ne syrgjýn ne burk dhe ne det, me kamçik edhe me xhelát, dhe i durove te gjitha per Zotin Krisht, o Mesonjes i kómbeve.

Si t' i tregojme mundimet, qe hoqte qe te dy, per fen' e per Ungjillin, dhe shpetimin e botes. Si Krishti o Shen Pjeter vdiqe mi Kryq, shpatevrár' o Shen Pal na lé; dhe i duruat te gjitha per Zotin Krisht, Apostúj te besníkeve.

LAVDI, T. II. Mblídhuni sot ketú, me bese t' i kremtojme, dy Apostújt' e Pare, te botes se Krishtere, Shen Pjetrin dhe Shen Palin tok.

TANI. O Zonje Shen Marí, te lútemi dëgjona, dhe tok me Apostujtë, Shen Pjetrin dhe Shen Palin, perhere nermjetó per né.

NDËNJËSORET, T. IV, EPEFANIS.

O Shen Pjeter Apostúll, prej peshkatari, kur e njohe Zotin Krisht, si shkemp te Kishes t' emerój, kyçet e qellit t' i dorzój, dhe te Parajses, ne krye te ƒngjjeve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprójtëse, per çdo nevojë, nermjetó per gjithë né, qe kemi shpresë permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besnikëve.

T. I, TON TAFON SU

Nga qelli more ftim, dhe me bujë u-thirre, prej Krishtit Perendí, Shpetimtarit te botes, qe lártazi more hir, dhe u-çfaqë si Apostúll, o Shen Pal me nam, o Ungjillór i palodhur, drit' e kómbeve, edhe themél i patundur, i Kishes se Aterve.

LAVDI DHE TANI. Si nene te Jesújt, qe te gjithë te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezikeve, dhe shpetimtare ne nga-sjet, o Nene Hyjlíndese.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Apostújt' e dëgjuar krerët me nam, qe shkëlqejnë si yjt' e ndritin ne qell, Shen Pjetrin qe kyçet mban, te Parajses se ƒngjjeve, edhe Shen

Palin me fame, leçites të kómbeve, që i kthen paganet në besën e Zotit Krisht; le t' i lavdërojme, se u-çfaqën të vyer, për rogen e jeteve, dhe për hirin e Shpirtit Shenjt, për andaj trashëguan pra, si shok' Apostuj të Jesujt, Mbreterin' e qiellit që s' ka mbarim, dhe nërmjetojnë pa prerë, për ndjesën e mekátave.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të përunjur o Shen Marí, që në shqotën e jetës brenda në det, po rrihet prej ëreve, dhe përpiqet prej vâlave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újeve, edhe në funt të Ferrit po krijhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpëto me dhe shpërme shpejt, në limán dhe në qetesí, se me besë po të therrës: Lutu-i Birit Jesú Krisht, të na dhuronjë ndjesën e mekátave, se me ty kemi shpresë, gjithë të pavýerit.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalcrisë, shumë pasione më leftojne, po ti perkrah-me dhe shpëto me, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërc krijesën për jetë-lindje.

PARËVARGU. Fama e tyre u-perháp ne tere boten.

UNGGJILLI I MENGJEZIT PAS JOANIT

M' até kohë, Jesúj passi u-ngjall se vdékuresh, u-çfaq ne Dishépujte, dhe e pyeti Simón Pjetrin: "Simón i Jonájt, a me dó mé teper se ketá?" Pjetri iu-pergjéq: "Po, o Zot, ti e di se te dua." Dhe Jesúj i tha: "Kullót-i shqerrat e mia." Pastáj e pyeti per se dyti: "Simón i Jonájt, a me dó?" Pjetri iu-pergjéq: "Po, o Zot, ti e di se te dua." Dhe Jesúj i tha: "Rúaji dhente e mia." Pastáj e pyeti per se treti: "Simón i Jonájt, a me dó?" Dhe Pjetri u-helmua qe e pyeti per se treti, dhe iu-pergjéq: "O Zot, ti i di te gjitha, ti e di se te dua." Dhe Jesúj i tha: "Kullót-i dhente e mia. Me te vertete, me te vertete po te them, kur ishe mé i ri, e ngjishnje brezin, edhe shkonje ku te deshnje, po kur te mplakesh, do t' i ndesh dúarte, dhe nje tjater do te ngjeshe, dhe do te veç atjé ku nuke dó." Dhe keté e tha per te treguar me ç' fare vdekje do ta lavdronte Perëndine. Dhe pastáj i tha: "Eja pas meje." Dhe Pjetri u-kthye, dhe vuri re qe po vinte pas edhe Dishépulli, qe deshte Jesúj, i cili i ra ne kraherorin, naten e darkes, dhe e pyeti: "Zot, cili esht aý qe te tradhetón?" Edhe Pjetri, kur e pá, e pyeti Jesune: "O Zot, po ky ç' dó?" Edhe Jesúj iu-pergjéq: "Kur une dua qe ky te qendronje gjer sa te kthehem prape, ti ç' ke? Ti eja pas meje." Pra, dolli fjala ne vellézerit, qe aý Dishepull nuke

vdes. Dhe Jesúj nuk i tha që nuk do të vdiste, po vetëm: “Kur unë dua që ky të qëndronjë gjer sa të kthehem prapë, ti ç’ ke?” Ky është Dishëpulli që i ka parë me sy dhe i ka shkruar këtë, edhe në e dimë se deshmimi i tij është i vertetë. Ka edhe shumë të tjera, që bëri Jesúj, të cilat po të shkruhen nga një e nga një, kujtonj se as bota e tere nuk do t’i nxere librat, që do të shkruhen. Amin.

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI. Me nermjetimet e Apostujve, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít’ e mia.

T. II. Pjetër o Kryetár, o Shkemp i Krishterimit, dhe Pal i lavderuar, që e perhaptë fenc, për né perherë lútuni.

SHKURTORJA, T. II

Lart në Parajs’ i ke, dy Apostujt’ e parë, se vuan dhe deshmuan, dhe ti u ke dhuruar, kuroren e Deshmóreve.

SHTËPIA

Ejani t’ i kremtojmë Apostujtë e lavderuar, Shen Pjetrin dhe Shen Palin, se e themeluan Krishterimin, dhe e perhapnë Ungjillin, dhe deshmuan për fenc, dhe perandáj fituan kuroren e Deshmóreve.

SINAKSARI

Me njezét e nente te ketí múaji, kujtojme Shen Pjetrin dhe Shen Palin, Apostujte e Pare, te lavderuar dhe emershkelqyer.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorczoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet sot i Larti prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá edhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjeresh' e pamartuar, Zotin e botes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besnikëve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen edhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po

Krijetarit lart, dhe kerccnimin me zjarr, e shkelle me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithe njérczit, keceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panaír te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmu-
ra, Virgjérësh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMESORET, T. II, TIS MATHITES

Eni t' i lavderojme sot, Apostújt' e degjuar, Pjetrin dhe Palin shoqerisht, si te Paret e Kishes, dhe yjt' e botes se tere, qe lecitne Ungjillin, trumbetat e doktrinave, dhe kollonat e Kishes me themelí, se per Krishterimin rane Deshmore, qe ta gatitin shigurisht, shpetimin per besniket.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i erresírave, mprona perpara gjyqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjereshë, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dore.

LAVDERIMET, T. IV, O EKS IPSISTU

Ti qe e more dhuratën qe prej qellit, kur pyeti

Zoti Krisht dhe Shpëtimtari Jesú, të Dymbëdhjetë Dishëpujtë, dyke u thënë: Ç' jam edhe ç' thone për mua njëzetit? Pjetri kryesónjesi, i Apostujve u-ngrit, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, edhe i thirri: Ti je i Bir' i Zotit të Krishtit je, dhe për-andáj e lumerojme sot, se e mori nga qelli këtë zbulim, dhe të lidh' e të zgjidhe gjithë barrat e mëkatave.

Ty që u-ftove që lartazi prej Zotit, edhe jo prej njëresve, nata e demoneve, ta erri syrin e trupit tënt, plot me mëkata, edhe me njolla të trashëgúara, befás që prej qiellit, drita u-derth mi ty, ta çeli syrin e shpirtit tënt syrin e besës, edhe a-here pé bukurín' e saj, edhe e njohe Shpëtimtarin Krisht, se nga nata në driten aý na nxier; eja pra dhe shpëtona, o Shen Pal o drit' e shpërteve.

Ti me të drejtë je guri edhe shkëmbi, ku Kishen e themelój për jetë Zoti Krisht, dhe besën tonë e shigurój, edhe të bëri, kryebarí të dhëneve me ment e shpirt; ty pra si besnik t' i dha, kyçet e qiellit, dhe të Parajsës së Engjëjve, dhe pret në derën, dhe sa të vijne me besë ti i qas; dhe për-andáj të lumerojme sot, se mi Kryqin dëshmove si Zoti Krisht; eja pra shpëtona, o Shen Pjetër Apostull me nam.

Ti o leçites që Kryqin pate mburrje,vojte keq se kishe mall, bes' e shpres' e dashurí, për një Triní dhe një Perendí, edhe për Kishen, edhe s' kurseve asnjé mundim për 'të; dhe veten e quajte, si rob të Zotit Krisht, se vojte pas porrosisë tij, mo-

hove veten dhe permi supet e ngrite Kryqin tent, dhe e pasove dhe more si çpërblím, Mbretë-rinc qellore të ƒngjicjve; eja pra shpëtona, o Shen Pal o drit' e shpërve.

LAVDI, T. T. II. E kremtja e nderuar, dhe shpëtimprëse e Apostujve, ardhi për Kishën e Krishtit. Pra le të dorëtrokasim mistikerisht, edhe le të thomi me zë të math: Gezohuni o Apostuj të shkelqyer, Shen Pjetër dhe Shen Pal, o themelira të patëndura, të dógmave të perëndishme, o enë të çmúra, o miq edhe shokë të Jesújt. Ejani midis nesh padukurisht, edhe vlerësónani, për dhuratat qellore, në qe kremtojmë kujtimin tuaj me kenge.

TANI. Ti je m' e lúmura, nga grat' e tërë botës, se lindi Shpëtimtarin; perkraha dhe dhurona, Parajsën e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatóreve me dhempshëri, se po të thërrësim besërisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjëreshë: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mëpro përherë gjith' atá, qe të lusin o Hyjlíndëse.

APOSTULLI

Fama e tyre u-përhap në tërë botën. Qelli e tregón lavdinë e Perëndisë.

Prej Letres II së Palit për Korinthianët.

Vellezer, per çdo gjë që janë kryelarter të tjeret, jam edhe unë, ndonëse është marrësi tjuaj them. Qenkan atá Hebrénj? Jam edhe unë. Qenkan atá Israeliter? Jam edhe unë. Qenkan atá nga fara e Abrahamit? Jam edhe unë. Qenkan atá sherbetore të Krishtit? Unë jam ca më tepër, ndonëse është marrësi ta them. Jam munduar më tepër, jam rrahur pa masë, jam burgosur më shpesh, e kam parë vdekjen me sy shumë herë. Judenjta me kanë dhënë pesë herë nga dyzët pa një fshíkulla; me kanë rrahur tri herë me shkop; me kanë shembur një herë me gurë; jam mbytur me anien tri herë; një nat' e një ditë kam bërë në funt të detit; kam vojtur shpesh në udhetime; në rezike prej luménjsh; rezike prej kusarësh; rezike prej farës sime; rezike prej paganësh; rezike në qytete; rezike në shkretëtira; rezike në dete; rezike në vellezer të rremë; në mundime dhe në lodhje; pa gjumë, pa buke dhe pa ujë; i zbathur dhe i çveshur në mes të dimrit. Edhe përveç vójtjeve të trupit, kam patur mi koke për ditë edhe kujdesin e gjithë Kísheve. Kush është i dobët, edhe nukë jam i dobët edhe unë? Kush është i lënduar, edhe nukë digjem edhe unë? Po neqóftese duhet të mburrem, do të mburrem më tepër për dobesitë e mia. Perendia dhe Ati i Zotit tonë Jesú Krisht, i cili është i bekuar për jetë, e di që nukë ju genjénj. Në Damaskë guvernori i mbretit Areta e rúante qytetin e Damaskéneve, se deshte të më zinte, dhe u-varra nga një dri-

tare pas murit brenda në një shportë, dhe shpëtova nga d'uarë e tij. Me të vertetë nuk më jep dorë të mburrem, se do të vinj në vizion dhe revellatë të Zotit. Njoh një njeri më Krishtin, i cili u-rembye gjer në qellin e tretë përpara katermbedhjetë vjeç, a më trup a jashtë trupit nuk e di, Perëndia e di. Edhe e njoh këtë njeri, a më trup a jashtë trupit nuk e di, Perëndia e di, që u-rembye në Parajsë, dhe degjój fjalë të pafólura, të cilat nuk është e përmetuar t' i flasë njeri. Për këtë po mburrem, po për veten time nuk mburrem veçse për dobësitat e mia. Se do të jem i marrë, sikur të mburrem, se do të them të verteten, po ndruhem se dikush munt të besonjë që vlenj më tepër seç më sheh edhe më degjón. Edhe që të mos mburrem shumë për këtë revellatë, më është dhënë një hell në trupin prej Satanit, që të më rrahë dhe të mos e ngre kokën përjetë. I jam lutur tri herë Zotit që të më çlironjë nga ky mundim, po aý më ka thënë: "Hiri im të mjaftón, se fuqia ime plotësohet me dobësi." Mbuurrem, pra, më gash të math për dobësitat e mia, që kështu fuqia e Krishtit të zbrësë mi mua.

UNGGJILLI PAS MATTHEUT

M' atë kohë, Jesúj vajti në krahinen e Kesarisë së Filipit, edhe i pyeti Dishépujtë: "Ç' thonë bota që jam unë, i Biri i njeriut?" Edhe Dishépujtë u-pergjeqnë: "Ca thonë se je Joán Pagarzori; ca të tjerë thonë se je Ellia; ca të tjerë thonë se je Jeremia a nonjë prej Proféteve." E-

dhe Jesú j i pyeti perserí: “Po ju ç’ thoni se jam unë?” Dhe Simón Pjetri u-përgjëq, edhe tha: “Ti je Krishti, i Biri i Perendise se gjalle.” Dhe Jesú j i tha: “Te lumte goja, Simón, i biri i Jonájt, se këtë gjë nuk e ta ka zbuluar nonjë njerí me mish e me gjak, po vete im-Atë, qe është në qell. Edhe unë po të them se ti je Pjetri, edhe mi këtë shkemp do ta ndertónj Kishen time; edhe forcat e Ferrit nuk e do ta rrezojnë dot; edhe do të jap kyçet e Mbretërisë se qellit; edhe ç’ të lidhesh mi dhënë do të jetë e lidhur në qell; edhe ç’ të zgjidhesh mi dhënë do të jetë e zgjidhur në qell.

KUNGATORJA

Fama e tyre u-perháp në tërë botën.

30. Mbledhja e të Dymbëdhjetë Apostujve të Shenjtes, të lavderuar dhe emershkelqyer.

PERLESHORJA E TË DYMBGDHJETËVE, T. III.

O Apostú j të Shenjtes, lútjuni Zotit tonë Jesú Krisht, tu falle shpírteve tona, ndjesën e mëkátave.

TË KREMTET E KORRIKUT

1. Kozmáj dhe Damiani, Anargjëndet e Shenjtes dhe çudiberes.

PERLESHORJA E ANARGJËNDEVE, T. T. IV.

Shen Anargjende çudiberes, Kozmá dhe Da-